

UDHËZIM Nr. 13, datë 09.05.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 16, DATË 3.4.2020,
“PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr. 87/2019, datë 18.12.2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 16, datë 3.4.2020, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

I. Në nenin 8 “Momenti i lëshimit të faturës”, pika 2 riformulohet, si vijon:

“2. Për furnizime në rastin e telekomunikacionit, transmetimit dhe shërbimeve elektronike për persona të patatueshëm, që kanë adresën e tyre të përhershme ose banojnë në Republikën e Shqipërisë, sipas nenit 29, të ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, furnizuesi i huaj nëpërmjet përfaqësuesit të tij tatimor në Republikën e Shqipërisë lëshon fatura dhe zbaton procedurën e fiskalizimit, në përputhje me ligjin, në momentin e furnizimit ose mund të lëshojë një faturë përmbledhëse periodike për shitjet totale të muajit jo më vonë se data 10 e muajit që pason muajin në të cilin janë dhënë shërbimet.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Delina Ibrahimaj